

AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “Star Energy“ shpk

Ne Tirane, sot me date 30 Maj 2024, ne cilesine e “ortakeve themelues “:

Z.Besim Kabashi, atesia Jair , i dtl 16.03.1982, Zoqisht, Kosove dhe banues ne Dan Retija, Zaqisht, Rahovec, Kosove. Shtetas Kosovar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. ID0671236.

Zj.Marsela Kurti, atesia Gezim , i dtl 27.03.1976, Sarande, Shqiperi dhe banuese ne Rruga Tanush Frasherri, Pallati 176, Tirane, Shqiperi. Shtetase shqipetare , madhore me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. H65327129G.

Z.Xhevrat Muqa, atesia Xhemajl , i dtl 03.11.1974, Vraniq, Kosove dhe banues ne Rruga Zaim Muqa p/n Vraniq 23000, Suhareke, Kosove. Shtetas Kosovar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. ID0185774.

Zj.Margarita Lazarou, atesia Laske , i dtl 09.07.1973, Sarande, Shqiperi dhe banuese ne Kokkinara 40 Kifisia, Greqi. Shtetase Greke, madhore me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. AK669828.

Te cilet ne cilesine e “ortakeve themelues “, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartuan kete akt themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ STAR ENERGY “ shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1
Krijimi


Shoqeria “ STAR ENERGY“ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “ Star Energy “**

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria “ STAR ENERGY“ shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket e shoqerise”, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbetje kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.



Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Rruga Frosina Plaku, Zona Kadastrale 8220, nr.Pasurie:3/506+5-32, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4

Objekti i veprimitarise

Tregtimi i paneleve diellor, Montimi dhe shitje e sitemeve fotovoltaike te prodhimit te energjis per nevoja familjare, tregtare etj, Në fushën e projektimit, projektim të impianteve të energjisë termike nga burime të rrinovueshme. Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rrinovueshme, diellore, nga era, etj. Projektim nënstacione elektrike, primar, sekondar - linja të tensionit të lartë. Projektim i kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linja të tensionit të ulët dhe të mesëm. Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale, për komplekse të telekomunikacionit, të ndriçimit rrugor, shesheve, dekorative dhe objekteve të mëdha sportive, Import të teknologjive të energjive të rrinovueshme si energjia fotovoltaika, energjia e turbinave me erë, turbinave hidro-energjitike, impianteve djegës të biomasës, impianteve djegës të gazit dhe petrolit si dhe ndërtim i sistemeve ngrohje-ftohje, klimatizatorë për ruajtjen e temperaturave në ambientet të ndryshme, Prodhim dhe shitje Energjje Elektrike, Konsulencë ne Sektorin e prodhimit te energjis fotovoltaika, dhe konsulencia te fushave te ndryshme .

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyhet apo te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga "ortaket e shoqerise".

Z. Besim Kabashi eshte zoterues i një kuote me vlerë 25.000 leke, e cila perfaqeson 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Zj. Marsela Kurti eshte zoterues i një kuote me vlerë 25.000 leke, e cila perfaqeson 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Xhevati Muqa eshte zoterues i një kuote me vlerë 25.000 leke, e cila perfaqeson 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Zj. Margarita Lazarou eshte zoterues i një kuote me vlerë 25.000 leke, e cila perfaqeson 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakeve te shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratoriёve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërbllimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoriët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoriёve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10 Administrimi

Administratoret e shoqerise jane:

Zi.Marsela Kurti i identifikuar me nr ID: H65327129G


Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per një afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakut te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person i trete jashtë ortakerise.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakut për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur :
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- Administratorii ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorii përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtë edhe autoritetet gjyqësore të



gjitha shkalleve. Administratorii angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, Administratori detyrohet:


1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid; b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyras së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.



Neni 13
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vtit finanziar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vtit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16
Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "STAR ENERGY" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakeve themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE

Z.Besim Kabashi Zj.Marsela Kurti Z.Xhevhat Muqa Zj.Margarita Lazarou

BESIM KABASHI
Besim Kabashi

Marsela Kurti
*Marsela Kurti
Okt 2024*

Xhevhat Muqa

Margarita Lazarou
Margarita Lazarou